



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA VI

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Integritet Evropian

Mbledhja nr. 28.

Prishtinë, më 30.10.2018 në ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Blerta Deliu-Kodra, Armend Zemaj, Fikrim Damka, Ismajl Kurteshi, Fatmire Kollçaku, Visar Ymeri, Ilir Deda, Zenun Pajaziti, Adem Hoxha dhe Milaim Zeka.

Mungon: Donika Kadaj- Bujupi.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Ahtere Loxha dhe Florent Mehmeti.

Pjesëmarrësit e tjerë: Përfaqësuesit nga GIZ, KDI dhe mediat.

Mbledhjen e kryesoi Blerta Deliu –Kodra, kryetare e komisionit

Kryetarja pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për punë e hapi mbledhjen e komisionit me këtë;

Rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 16.10.2018;**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-007 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-007 për procedurën jokontestimore, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;**
- 4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-008 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/26 për trashëgiminë në Kosovë, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;**

- 5. Shqyrtimi i Projektligji nr. 06/L-077 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 2004/32 për familjen i Kosovës, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;**
- 6. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës.

Rendi i ditës u miratua i pa ndryshuar.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 16.10.2018.

Procesverbali i mbledhjes së kaluar u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-007 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-007 për procedurën jokontestimore, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së.

Kryetarja paraqiti opinionin ligjor për Projektligjin, çështjet që rregullohen me këtë projektligj, mbeten kompetencë e brendshme e shteteve anëtare dhe nuk janë të rregulluar në mënyrë specifike me legjislacionin e BE-së.

Andaj konstatohet se ky Projektligj me amendamentet e Komisionit Funkcional nuk është në kundërshtim me legjislacionin e BE-së, prandaj mund të rekomandohet për miratim në Kuvend.

Kryetarja e hapi diskutimin dhe pas votimit konstatohet se komisioni nxori këtë:

Rekomandim

Projektligji nr. 06/L-007 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-007 për procedurën jo kontestimore së bashku me amendamentet e Komisionit Funkcional nuk është në kundërshtim me legjislacionin e BE-së dhe, si i tillë mund të rekomandohet për miratim në Kuvend.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-008 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/26 për trashëgiminë në Kosovë, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së.

Kryetarja lidhur me Projektligjin paraqiti opinionin ligjor, çështjet që rregullohen me këtë projektligj, mbeten kompetencë e brendshme e shteteve anëtare dhe nuk janë të rregulluar në mënyrë specifike me legjislacionin e BE-së.

Andaj konstatoj se ky Projektligj me amendamentet e Komisionit Funkcional nuk është në kundërshtim me legjislacionin e BE-së, prandaj mund të rekomandohet për miratim në Kuvend.

Kryetarja hapi diskutimin dhe pas votimit konstatoj se Komisioni njëzëri nxori këtë:

Rekomandim

Projektligji nr. 06/L-008 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2004/26 për trashëgiminë në Kosovë, me amendamentet e Komisionit Funkcional nuk është në kundërshtim me legjislacionin e BE-së dhe si i tillë mund të rekomandohet për miratim në Kuvend.

4. Shqyrtimi i Projektligji nr. 06/L-077 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 2004/32 për familjen i Kosovës, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së.

Kryetarja, lidhur me Projektligjin, paraqiti opinionin ligjor, çështjet që rregullohen me këtë projektligj, mbeten kompetencë e brendshme e shteteve anëtare dhe nuk janë të rregulluar në mënyrë specifike me legjislacionin e BE-së.

Andaj konstatoj se ky Projektligji me amendamentet e Komisionit Funkcional nuk është në kundërshtim me legjislacionin e BE-së, prandaj mund të rekomandohet për miratim në Kuvend.

Kryetarja e hapi diskutimin dhe pas votimit konstatoj se komisioni njëzëri nxori këtë:

Rekomandim

Projektligji nr.06/L-077 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.2004/32 për familjen i Kosovës, me amendamentet e Komisionit Funkcional nuk është në kundërshtim me legjislacionin e BE-së dhe si i tillë mund të rekomandohet për miratim në Kuvend.

5. Të ndryshme

Kryetarja tha se nga Drejtoria për protokoll jemi njoftuar se Komisioni i Senatit Italian për Politikën e Bashkimit Evropian ka shprehur gatishmërinë për të realizuar një vizitë në Kosovë. datat e propozuara janë 15 dhe 18 nëntor.

Ilir Deda tha se në vitin 2015, një delegacion i Komisionit për Integritet së bashku me ish ministrin e integriteteve z. Çollaku, patën lidhur një memorandum të bashkëpunimit me Komisionin e Senatit për Çështje Evropiane për konsultime politike, për t'u takuar dy herë në vit, por ajo nuk u jetësua kurrë, sepse kryetarja e atëhershme e komisionit shkoi në Nju Jork dhe nuk është vazhduar nga kryetarja e re. Andaj ne takim duhet me e rikonfirmuar marrëveshjen e cila ka qenë mes dy komisioneve dhe me filluar me

caktua datën e ardhshme të takimit dhe të dy komisionet me e pasur permanente vijën politike.

Kryetarja u ndërlidh dhe tha duhet me u konsultua me ish -kryetaren e komisionit dhe z. Çollaku se cila ka qenë marrëveshja dhe a ka pas ndonjë lëvizje, kurse sa i përket deklaratës se ministres do të ishte mirë me pasur në njëërën prej takimeve këtu, por nuk e di se çka mundet me na thënë, sepse ne i kemi kryer obligimet dhe pajtohëm me pasur përkushtim institucional deri ne fund dhe muaji nëntor me qenë më dinamik.

Armend Zemaj mendon se është e nevojshme të ftohet ministrja në këtë fazë, jo me e korrigjuar gjuhën që e përdor Qeveria, por se paku me e ruajtur disponimin politik që e ka edhe komisioni, sidomos rreth temës se integriteteve. Në vazhdim tha se nuk po pajtohëm me atë që u tha çka do t'i themi ministres në këtë fazë, mirë është t'i themi se është mirë me e u koordinuar sepse jemi pajtuar të koordinohemi rreth kësaj agjende që të kemi një impaktë, sepse gjatë kësaj kohe që nuk janë as dy muaj, nuk duhet të dorëzohemi, por të vazhdojmë me lobimin, por nëse nuk ka përgjigje pozitive, sinqerisht nuk e di se cili politikan serioz do të dalë para qytetarëve të vendit me folur për liberalizim të vizave dhe për integritete evropiane dhe nuk e di se si do të vazhdojë më tutje kjo Qeveri dhe ky Kuvend.

U potencua se ka qenë iniciativë më e hershme që senatorët e Parlamentit Evropian ta vizitojnë Kosovën dhe po flas nga koha kur kam qenë ne mandatin e kaluar kryetar i grupit të

Miqësisë Kosovë-Itali, tani janë riaktivizua këto tema dy paleshe, por edhe atje kanë qenë 3 apo 4 palë zgjedhje prej se është bërë ajo marrëveshje, fatkeqësia është se ne nuk kemi memorie institucionale sepse me u pas përcjellë këto elemente, ne bashkëpunimin e kishim pasur më të lehtë.

Shpresoj se edhe ne duhet me qenë të përgatitur kur takohemi për me i adresuar kërkesat.

Fatmire Kollçaku tha se të gjithë ne jemi të interesuar që të ndodhë procesi i liberalizimit të vizave, por nëse diku do t'i faturohet si dështim do të jetë ky koalicion qeverisës. Prandaj me intereson ku jemi ne sa i përket agjendës se komisionit për lobim dhe a kanë lëvizur gjërat në atë drejtim, siç kemi biseduar dhe a do të zhvillohet vizita e paraparë në Gjermani tani në fillim të këtij muaji?

Megjithëse kemi qenë skeptik, është shumë e pa drejtë që ne mos ta fitojmë liberalizimin, megjithëse BE-ja është dashtë me na afruar pak më shumë, sepse mos liberalizimi i vizave do të jetë goditja me e madhe që do t' ju bëhet qytetarëve.

Zenun Pajaziti, sa i përket takimit me ministren, tha se sa me shumë takime me pasur me ministren është më mirë, meqenëse ne kemi pas shfaq një gatishmëri me herët dhe kemi kërkuar me u koordinuar për një agjendë, por nuk e di sa kemi mundur me u integruar në këtë proces dhe do të ishte mirë që me ministren me shikuar se a ka ndonjë hapësirë me ndikuar në këto shtete.

Pajtohem qe ka pasur deklarime nga ministria qe ka qenë disa nota me poshtë, kurse zëvendëskryeministri ka qenë me i ashpër, kur kemi përmendur data kemi pasur kritika të ashpra nga BE-ja, nëse ne vazhdojmë me ia bërë me gisht njëri- tjetrit se kush i ka fajet, ka me u shtyrë liberalizimi i vizave, duhet me pasur qëndrim më parimor dhe më të sinqertë partitë politike në këtë proces.

Visar Ymeri tha se ne duhet me pasur një ton më të ashpër karshi BE-së, nëse këtë radhë në dhjetor nuk marrim vendim për liberalizim të vizave, kushtëzimi që vjen nga BE-ja nuk do të ketë vlerë sepse këta po e hupin mundësin e kushtëzimit, sepse kur kanë kushtëzuar Republika e Kosovës me shumë mund i ka përmbushur kriteret, atëherë këta nuk e kanë mbajtur anën e vet të kontratës, atëherë pse ne me i miratuar gjërat që na i kërkon BE-ja, që janë në kundërshtim me vullnetin politik, siç ishte rasti me demarkacionin. Në këso rrethanash duhet t' ju bëhet e qartë të gjithëve se do të ketë reperkusione edhe në dialogun me Serbinë, sepse nëse dialogu me Serbinë është diçka që me se shumti e shtynë BE-në edhe Kosova e pranon edhe për shkak të BE-së atëherë kjo do të ketë reperkusione, sepse nuk mund të ketë dialog me Serbinë nëse BE-ja vazhdon kështu.

Natyrisht që përgjegjësia e institucioneve tona nuk hedhet poshtë, sepse kemi dështuar shumë në drejtësi dhe sundimin e ligjit dhe kemi marrë shumë faje e përgjegjësi mbi vete edhe atëherë kur nuk kemi pasur.

Ne kemi përgjegjësi, por ka vende qe janë me keq se ne, ne sundimin e ligjit dhe fusha të tjera dhe ju kanë hequr vizat. Komisioni Evropian ka rekomanduar se janë përmbush kriteret, tash po dalin shtetet e po thonë na duhen informata shtesë, le të tregojnë tani se cilat janë informatat shtesë, ne mundemi me ju dhënë. Ne këtë drejtim na duhet me mbajt atë vijë që e kemi diskutuar me herët të shpjegimit dhe të lobimit, por edhe nga pak kërcënues. Ne nuk mundemi me i shtie me zor ata me marrë vendim pozitiv, por duhet me ju treguar që kjo e dëmton goxha shumë marrëdhënien e Kosovës me BE-në. Kishte me qenë mirë që përfaqësuesit e partive politike kur të flasin me i pas parasysh, sepse politika funksionin në bazë të kushtëzimeve, e jo bindjeve, kushtëzimet nuk i kemi të mëdha dhe nuk duhet me e qitur veten në pozitë inferiore karshi BE-së dhe duhet me ndryshuar marrëdhënien religjioze që e kemi pasur deri tash me BE-në në marrëdhënie politike. Në politik të shenjtë krejt nuk janë, të gjithë janë të gabueshëm dhe ne i kemi bërë disa gabime dhe i marrim për mbi vete. Nuk është vonë që ne të vazhdojmë me lobim dhe gjatë muajit nëntor duhet me tepër me insistuar me shumë për çfarëdo forme të kontaktit me ta, ose ne me shkuar atje në vizitë apo ata me ardhur këtu dhe me ju treguar qëndrimin politik të partive politike dhe institucioneve tona karshi liberalizimit të vizave.

Ne fund tha se ne edhe një herë duhet me kërkuar nga institucionet me pas deklarata të koordinuara, por janë shumë sporadike dhe në asnjë pikë nuk po mundemi me arritur një koherencë institucionale që me e paraqit një qëndrim të përbashkët shtetëror karshi një çështje.

Kryetarja, lidhur me vizitat për lobim, tha se ambasadori gjerman na ka thanë se i ka dërguar letrat dhe ka kërkuar qe sa më shpejt me u realizua takimi, gjatë kësaj jave e

kemi takimin me Komisionin Gjerman për Legjislacion dhe Mbrojtje të Konsumatorëve, e kemi marrë një deklaram edhe nga ambasadori gjerman dhe kërkoj me qenë xhentil karshi kërkesës për liberalizim dhe me qenë një deklaram i unifikuar dhe me diskutuar për liberalizim vetëm me argumentet që Kosova i ka përmbushur kriteret, mu duk se ke një qasje me pozitive sa i përket Gjermanisë.

Ilir Deda tha se ne duhet me qenë shumë të kujdesshëm dhe unik karshi liberalizimit të vizave. Ne nuk jemi më keq se disa shtete që e kanë liberalizimin, si Kolumbia, Moldavia, Ukraina dhe Gjorgjia, tani po thonë se duhet të korrigjohen disa kriteret, por nuk tregojnë cilat janë ato kriteret.

Lidhur me takimin me delegacionin gjerman propozoj që me pas paraprakisht një takim konsultativ për me qenë unik se çka duam të bisedojmë, sepse nëse këta kthehen me vendim pozitiv ka mundësi të mëdha që Gjermania me thënë po.

Fatmire Kollçaku tha se gjatë takimeve komisioni duhet me pasur qëndrime unike dhe gjithnjë me u thirr ne deklaratat dhe qëndrimet e zyrtarëve më të thirrur evropian që kanë qenë publike, sidomos te kushti i demarkacionit, e dimë çka na kanë thënë para ratifikimit dhe deklaratat që kanë thënë se janë plotësuar kriteret e çka tash?

Kurse sa i përket luftës se krimit të organizuar dhe korrupsionit, kjo është betejë që kur nuk përfundon, por mandej ne brenda shtetit mundemi t' i thërrasim përgjegjës tanë me qenë serioz që tash e tutje mos ta dëmtojnë procesin me disa vendime.

Zenun Pajaziti pyeti anëtarët dhe tha se a mundemi ne, si komision, me e organizuar një konferencë të përbashkët dhe me i deklaruar qëndrimet tona, që ne si përfaqësues të krejt spektrit politik që i kemi përcjellë kemi plot pa kënaqësi që në këtë vend ka mundur me u bë më shumë, por kriteret për liberalizim të vizave i kemi përmbushur, këtë e kanë verifikuar institucionet e BE-së, dhe pritja jonë e përbashkët, shoqërisë civile dhe të gjithëve është se këtë fund vit po ju presim për vendim.

Fatmire Kollçaku u ndërlidh dhe tha se ne nëpër takime vetëm duhet me u bazuar në deklaratat e tyre dhe me i listuar të gjitha me radhë, sepse ata tani po marrim vendim e jo ne.

Armend Zemaj tha se propozimi i deputetit ma ndërroi pak mendimin që e pata me thënë, por kur ne po flasim kishim mundur me bërë, po nuk po mundemi sepse po e shohim se nuk ka agjendë të përbashkët, nuk ka koordinim efikas të institucioneve, lufta për merita nuk është brenda komisionit, lufta politike po bëhet brenda në qeveri. Ne u munduam me i përdor krejt mekanizmat tanë me ambasadorët dhe me njerëz kompetent, kurse sot diskutimi kthehet prapë atje ku kemi fol para një muaji.

Kryetarja njoftoi lidhur me vizitën e Komisionit për Çështje Evropiane i Kroacisë që është shtyrë për nëntor, dhe gjatë nëntorit në komision për vizitë tha se do të vijnë edhe Komisioni për Çështje Evropiane i Gjermanisë, si dhe Komisioni për Çështje Evropiane i Senatit Italian.

Në vazhdim tha se është shqetësuar dhe nuk e di si t'i qasemi ministrit për Punë të Jashtme dhe ministrit për Punë të Brendshme, 3 herë i është dërguar ftesa dhe gjithmonë përgjigjet me arsyetimin se është jashtë vendit dhe kërkon mirëkuptim për takime të reja. Kurse ministri i Punëve të Brendshme na ka kërkuar mirëkuptim se është ministër i ri dhe javën e parë të nëntorit do të vijë.

Ismajl Kurteshi diskutoi për 3 çështje: për përgjegjësinë e ministrave, duhet t'ju bëhet edhe një ftesë dhe të paralajmërohet se do të bëhet publike mos përgjegjësia e tyre dhe në të njëjtën kohë duhet me njoftuar edhe kryeministrin dhe me e ngrit këtë çështje edhe në Kuvend.

Kurse sa i përket konferencës për shtyp që e përmendi deputeti Zenuni, tha se nuk ka të keqe të mbahet, por ne jemi çdo ditë para mediave edhe këtu në komision edhe njëherë mund të deklarohemi për gatishmërinë e komisionit që ta shtyjme këtë proces përpara.

Kurse për çështjen e tretë që e mendon si të rëndësishme tha, qëllimi i takimit me Kryetarin e Kuvendit të Kosovës dhe me ministren e Integritetit, ishte koordinimi për lobim, por nuk ka ndodhur asgjë, andaj do të duhej të kërkohej edhe njëherë sidomos nga ministrja e integritetit dhe të insistohet nga ajo që të ulet me komisionin për një takim, i cili do të rezultojë për koordinim të përbashkët për periudhën e mbetur deri kah mesi i dhjetorit.

Përveç takimeve me ambasadorët nuk ka pasur asgjë të koordinuar dhe këto takime nuk janë koordinuar me ministren.

Në vazhdim edhe anëtarët e tjerë të komisionit propozuan që t'ju përsëritet edhe një herë ftesa ministrave dhe nëse nuk vijë atëherë te ju bëhet vërejtje publike në seancë.

Kryetari tha se kemi biseduar së bashku me GIZ-in dhe deputetin Zenun Pajaziti që janë edhe përfaqësues politik në Forumin për transparencë dhe mendoj që është një ide e mirë që nëse ka pajtueshmëri me u mbledhur bashkë edhe për shkak të asaj që kemi një deklaramë unike karshi BE-së që dhjetori me qenë një datë që ne presim vendim. Ne e kemi paraparë një takim me Forumin, ka hyrë në agjendë dhe ia dha fjalën Zenun Pajaziti të njoftoj lidhur me këtë.

Zenun Pajaziti: Pasi që shoqëria civile me Kuvend funksionojnë brenda këtij forumi, tha se ideja ka qenë që Komisioni i Integritetit me e organizuar një takim me shoqërinë civile në frymën e aktiviteteve me temë liberalizimin e vizave dhe është mirë sa më shpejt me u koordinuar.

Në fund, pasi që edhe anëtarët e tjerë të Komisionit u pajtuan që t'ju përsëritet edhe një herë ftesa ministrave kryetarja kërkoi që të përsëritet ftesa për herë të fundit dhe nëse nuk vijë tha, do të na detyronë ta ashpërsojmë gjuhën tonë në raport me qeverinë, sepse nuk po janë të përgjegjshëm dhe nuk po vijë në takimet që po ftohen dhe do t'ju bëjmë vërejtje publike në seancë plenare, sidomos ministri i Punëve të Jashtme asnjëherë nuk ka ardhur gjatë këtij mandati me raportuar, gjithnjë duke u arsyetuar se gjendet jashtë vendit.

Mbledhja përfundoi në orën 12:25.

Përgatitur nga:
Njësia për mbështetjen e komisionit

Kryetare e komisionit,

Blerta Deliu -Kodra